

Implementimi i Sistemit Ndërbankar të Pagesave në Kosovë

Të nderuar përfaqësues të Bankës Botërore,

Të nderuar përfaqësues të bankave komerciale,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Ju uroj mirëseardhje në konferencën për media me qëllim të njoftimit për implementimin e suksesshëm të sistemit për pagesa ndërbankare nga ana e BQK-së.

Ky projekt në fushën e sistemeve të pagesave është realizuar sipas standardeve më të reja ndërkombëtare, teknologjisë më bashkëkohore, si dhe praktikave më të mira në botë. Ky projekt e bën Kosovën të shquhet edhe në aspektin ndërkombëtar me një sistem bashkëkohor të pagesave. Për përgatitjen dhe realizimin e këtij projekti, kemi pasur mbështetje financiare dhe teknike nga Banka Botërore, për çka e falënderoj shumë.

Siç dihet, objektivi parësor i BQK-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Andaj, jetësimi i një sistemi bashkëkohor të pagesave ka qenë një sfidë e natyrshme në kuadër të zhvillimit të gjithmbarshëm të veprimtarisë së BQK-së. Përgatitja dhe implementimi i tij ka qenë në mesin e veprimeve më të rëndësishme në Planin Strategjik të BQK-së dhe komponenti kryesor i vizionit të së ardhmes të Sistemit Kombëtar të Pagesave.

BQK-ja, në bashkëveprim me Bankën Botërore, në qershor të vitit 2015, ka kontraktuar kompaninë amerikane "Montran", e cila ka implementuar projektin sipas dinamikës së paraparë. Realizimi i projektit është rezultat i punës së ekipeve punuese dhe stafit të BQK-së, bankave komerciale, Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave si dhe institucioneve të tjera pjesëmarrëse në sistem të pagesave. Me këtë rast dua t'i falënderoj të gjitha institucionet e përfshira për përkushtimin dhe kontributin e tyre në projekt.

Është arritur që mijëra pagesa të qytetarëve, pagesat e pagave dhe pensione, pagesat e shërbimeve publike, pagesat e taksave dhe tatimeve, pagesat për sigurime të ndryshme, si dhe shumë lloje e kategori të tjera të pagesave, të realizohen në mënyrën më të shpejtë, më të sigurt dhe më efikase të mundshme përmes Sistemit të Pagesave Ndërbankare të BQK-së. Ndërsa, mund të kujtojmë që para 15 viteve në institucionin pararendës të BQK-së, Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, ishte filluar nga zeroja, me një sistem të thjeshtë manual të kliringut të pagesave, që karakterizohej me shkëmbim të një numri të kufizuar të urdhërpagesave në letër me dy bankat e vetme komerciale që operonin në Kosovë në atë kohë. Arritja e parë e rëndësishme në rrugën e zhvillimit ishte kalimi në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar, duke vazhduar me zhvillime të vazhdueshme rregullatore, funksionale dhe teknologjike.

Në vazhdimësinë e zhvillimeve dhe të arriturave, sot shënojmë arritjen më të rëndësishme deri më tani - Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar është zëvendësuar tërësisht me Sistemin e

Transferit Automatik (STA), një sistem ky që, siç u cek fillimisht, reflekton standardet, funksionalitetin dhe teknologjinë më të fundit. Vlerësojmë se implementimi i këtij sistemi është një ndër hapat kryesorë që BQK-ja ka ndërmarrë për forcimin e stabilitetit financiar në vend si dhe rritjen e efikasitetit të sektorit bankar në veçanti. Sistemi i Transferit Automatik (STA) përbëhet nga dy komponentë kryesorë:

- Komponenti i transferimit të fondeve në kohë reale (RTGS) , dhe
- Komponenti i procesimit në grup të pagesave me vlerë të vogël (ACH)

Pos përparësisë së përgjithshme, Sistemi i Transferit Automatik ka një numër atributesh të veçanta pozitive që duhet të nënvizohen:

- shlyerja e menjëhershme në kohë reale për pagesa me vlerë të madhe dhe atyre me prioritet,
- krijimi i lehtësirave në procesim,
- rritja e efikasitetit për menaxhimin e përditshëm të likuiditetit nga ana e vetë bankave,
- ulja e rreziqeve në sistemin bankar,
- përdorimi me kosto të volitshme dhe të përballueshme për përdoruesit;
- krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme për inkurajimin e mëtejshëm të zhvillimeve të industrisë bankare dhe zhvillimit të tregjeve financiare.

Në fund, dua të theksoj se krahas implementimit të sistemit të ri të pagesave, që nga data 30 qershor 2016 ka filluar edhe aplikimi i IBAN-it edhe për pagesat vendore që do të ndikojë në unifikimin dhe standardizimin e procesit të kontrollit të vlefshmërisë së llogarive bankare.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!